



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:185980

Datë: 30.11.2021

Numri i dokumentit: 02452778

P. nr.917/19

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurit G.Gj., duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit me QN.nr.203/2021, të datës 25.11.2021, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj në mes të pandehurit, G.Gj.në njërën anë dhe të dëmtuarit Y.H., në anën tjetër, sipas aktakuzës së PP/II.nr.1974-5/18, të datës 23.8.2019, për shkak të veprës penale Lajmërimi apo kallëximi i rremë nga neni 390 par.2 lidhur me par. 1 të Kodi Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së) në mbështetje të nenin 15 par.1 te Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, më datën 30.11.2021 mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET marrëveshja QN.nr.203/2021, të datës 25.11.2021, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj në mes pandehurit G.G.G., lindur më dt. ..., me vendbanim në Prizren, rruga “...” pa nr, në njërën anë dhe të dëmtuarit Y.H. nga Prizreni, rruga “...” nr. ..., në anën tjetër.

Hudhët aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1974-5/18, e datës 23.8.2019 dhe PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurit G.Gj., për shkak të veprës penale Lajmërimi apo kallëximi i rremë nga neni 390 par.2 lidhur me par. 1 të Kodi Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.1974-5/18, të datës 23.8.2019, të pandehurin e ka akuzuar për vepër penale, Lajmërimi apo kallëximi i rremë nga neni 390 par.2 lidhur me par. 1 të Kodi Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së. Me dakordimin e palëve në shqyrtimin fillestar të mbajtur me dt. 25.11.2021, konform nenit 4 dhe 8 të Ligjit për ndërmjetësim, u vendos që lënda të dërgohet në Qendër për Ndërmjetësim.

Me datën 25.11.2021, në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj është arritur marrëveshja QN.nr.203/2021, në mes palëve në procedurë.

Andaj Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenin 15 par.1 të ligjit për Ndërmjetësim e aprovoj këtë marrëveshje pasi që e njëjta u vlerësua se është lidhë me vullnetin e plotë të palëve për çështjen dhe është në pajtim me ligjin për ndërmjetësim në fuqi.

Konform nenin 15 par.1 të ligjit për Ndërmjetësim më datën 30.11.2021, aprovohet nga gjykata marrëveshja për ndërmjetësim dhe e njëjta do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Konform nenit 454 par.1 të KPK-së shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 253 par. 1 pika 1.3 të KPPK lidhur me nenin 15 par.1 të ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL
P.nr.917/19, me dt.30.11.2021.

Zyrtare Ligjore

Gjyqtari i vetëm gjykues

Kimete Bytyqi

Imri Sejda

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 3/tre/ditëve nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate.